



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:113120
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05507454

KPPP.nr.348/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit TEB Sh.A., me seli në zyrën qendrore në Prishtinë rruga “Agim Ramadani”,15, kundër debitorëve: 1. DPZ PREKADINI, me adresë në Klinë rruga “Dëshmorët e Kombit”, me NRB: 70652617 (kredimarrësi), 2. E.P. me adresë në Jashanicë, Klinë (bashkë-kredimarrësi), 3. M.D., me adresë në Klinë, rruga “Dëshmorët e Kombit” (garantues), 4. N.B., me adresë në Klinë (garantues), të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm A.D. nga Klina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit N.B. të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.80/17 të datës 23.03.2017, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 24.07.2023, në të cilën kanë prezantuar të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me datë 26.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit N.B. nga Klina, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.80/17 të datës 23.03.2017, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbarimor në bazë të dokumentit përmbarimor Marrëveshjes mbi Kredi Personale nr.21876 dhe Shtojcës mbi Pengun të datës 26.06.2012, Marrëveshjes mbi Mbitërheqjen e Mundësuar nr.57723 dhe Shtojcës mbi Pengun të datës 21.09.2016, si dhe shtojcave 3 të datës 26.07.2018 dhe shtojcën 4 të datës 16.10.2019, dhe Marrëveshjes mbi Hipotekën Nr.21676 të datës 26.06.2012, me të cilin ka urdhëruar të bllokohen të gjitha llogaritë bankare të gjithë të përmbaaruarve, përfshirë llogaritë personale të udhëhequra në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe të konfiskohen të gjitha mjetet financiare deri në shumën dhe atë ndaras për palët: DPZ PREKADINI e përfaqësuar nga A.P. dhe E.P. deri në shumën 9,679.90 Euro, M.D. dhe N.B. (garantues për kredinë nr.24685) në shumën prej 4,409.47 Euro, i cili është borxhi për kredinë nr.21676 të datës 20.06.2012 për të cilët palët kanë nënshkruar. Në bazë të marrëveshjeve të lartcekura si dhe propozimit të kreditorit, sekuestrohen: Lista e mallit, Lista e mjeteve fikse, Automjeti Volkswagen lloji 19 E, Automjeti Volkswagen lloji Passat TDI, Lista e mallit dhe mjetet fikse. Mbyllja e detyrimit të bëhet poashtu me shitjen e patundshmërisë së evidentuar në bazë të Certifikatës mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme me nr.232 të datës 19.06.2012, e cila evidentohet në emër të N.B., për sigurimin e kredisë në vlerë prej 20,000.00 Euro, me kamatë vjetore 14.4 %, dhe me afat të kthimit për 60 muaj. I ndalohet debitorëve tjetërsimi i sendeve të lëna peng nën kanosjen e pasojave ligjore. Detyrohen debitorët që të kompenzojnë shpenzimet e procedurës së përmbarimit sa ato do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të Organit Përmbarues.

Kundër urdhrit përmbarimor, debitori N.B. përmes përfaqësuesit të përkohshëm, avokat A.D., në afatin e paraparë ligjor ka ushtruar prapësim, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se kredimarrësi DPZ Prekadini, i përfaqësuar nga A.P. dhe E.P., dhe garantuesi tjetër M.D., kanë lënë garancion/peng gjësende të tjera të luajtshme. Më tej ka theksuar se Përmbaruesi Privat duhet fillimisht të zbatoj përmbarimin në sendet të cilat janë lënë peng nga kredimarrësit, të cilat sende e tejkalojnë vlerën e borxhit të cilën e kërkon kreditori, e jo ta shfrytëzojë mos prezencën e garantuesit N.B., i cili gjendet në vendbanim të panjohur, dhe të realizojë direkt shitjen e paluajtshmërisë, e cila ka vlerë shumë më të madhe se borxhi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri P.nr.80/17 i datës 23.03.2017, sa i përket garantuesit N.B..

Kreditori në përgjigje në prapësim e konsideron prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të paraqitur vetëm me qëllim të zvarritjes së procedurës përmbarimore. Më tej ka theksuar se sa i përket pretendimeve të debitorit se Përmbaruesi duhet fillimisht të veprojnë në peng, kjo nuk është e saktë, sepse në momentin e vonësës garantuesit janë të njëjtë, dhe veprimi ndaj tyre mund të bëhet në të njëjtën kohë ose sipas zgjedhjes së kreditorit. Ka shtuar se kreditori dhe debitori kanë lidhur marrëveshjen e kredisë për kohë të caktuar dhe data e pagesës ka qenë e caktuar saktë, dhe se konform dispozitave të LPP-së Marrëveshja e Pengut paraqet titull ekzekutiv. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorëve i datës 26.08.2020 të refuzohet si i pabazuar ndërsa të vërtetohet urdhri përmbarimor si dhe të vazhdohet me procedurën e përmbarimit.

Gjykata Themelore në Pejë – dega në Klinë, me aktvendimin CPP.nr.58/20 të datës 07.04.2021, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit N.B., të parashtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.80/17 të datës 23.03.2017 të Përmbaruesit Privat Gjakë Radi.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.4644/21 të datës 25.08.2022 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit N.B., duke e anuluar vendimin e shkallës së parë CPP.nr.58/20 të datës 07.04.2021, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, dhe aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 38 të LPP-së, duke e udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që në rivendosje t'i evitohet paqartësitë në këtë lëndë përmbarimore.

Gjykata në rivendosje, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimin të debitorit, në kuptim të nenit 73, par.1 të LPP-së, me datë 24.07.2023 ka caktuar seancën dëgjimore lidhur me këtë çështje përmbarimore.

Përfaqësuesi i përkohshëm i debitorit N.B., avokati A.D., gjatë seancës dëgjimore e ka kundërshtuar propozimin e kreditorit duke sqaruar se N.B. në vitin 2012 me tokën e tij Parcelën me nr.273-0 ZK Dolc ka garantuar për kredinë në shumë prej 20,000.00 Euro, ndërsa kur është ushtruar propozimi shihet që nga kjo shumë kanë mbetur edhe 4,409.47 Euro, ndërsa për kredinë apo mbitërheqjen N.B. nuk ka garantuar në këtë parcelë apo me diçka tjetër, mirëpo me konkluzionin e Përmbaruesit Privat të datës 11.06.2021 është tentuar të shitet kjo parcelë për tërë borxhin edhe për atë të vitit 2016. I ka kërkuar edhe shpenzimet për seancën e shtyrë në shumën prej 67.50 Euro, dhe për seancën e datës 24.07.2023 shumën prej 135 Euro.

Kreditori, gjatë seancës dëgjimore, ka deklaruar se deri në ditën e sotme (datë 24.07.2023), borxhi total është 9,417.02 Euro, si dhe për overdraft/mbitërheqje shumë prej 5,150.04 Euro që në total është shuma në vlerë prej 14,567.06 Euro. Në seancën e datës 24.07.2023 i njëjti e ka dorëzuar një parashtrësë të rrjedhës së kësaj procedure prej inicimit të propozimit për përmbartim e deri në kthimin e kësaj çështje në rivendosje.

Pas mbajtjes së seancës dëgjimore, shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e Përmbartuesit Privat bazohet në dokumentet përmbartuese Marrëveshjes mbi Kredi Personale nr.21876 dhe Shtojcës mbi Pengun të datës 26.06.2012, Marrëveshjes mbi Mbitërheqjen e Mundësuar nr.57723 dhe Shtojcës mbi Pengun të datës 21.09.2016, si dhe shtojcave 3 të datës 26.07.2018 dhe shtojcën 4 të datës 16.10.2019, të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.7, nenit 27 të LPP-së dhe nenit 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, për t’u paraqitur si dokumente përmbartuese dhe përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase Marrëveshja mbi Hipotekën Nr.21676 e datës 26.06.2012, sipas të cilës paluajtshmëria e ngarkuar me hipotekë evidentohet në emër të debitorit N.B. si parashtrues i prapësimit, është e regjistruar në regjistrin e hipotekës sipas Aktvendimit mbi Regjistrimin e Hipotekës me nr.të protokollit nr.248/2012, të datës 29.06.2012.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se Përmbartuesi Privat duhet fillimisht të zbatoj përmbarimin në sendet të cilat janë lënë peng nga kredimarrësit, të cilat sende e tejkalojnë vlerën e borxhit të cilën e kërkon kreditori, e jo ta shfrytëzojë mos prezencën e garantuesit N.B., i cili gjendet në vendbanim të panjohur dhe të realizojë direkt shitjen e paluajtshmërisë, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore. Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.348/23, me datë 26.03.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.